

VENDIM
Nr. 175, datë 8.3.2017

PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

(ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.4.2017; nr. 265, datë 16.5.2018; nr. 60, datë 13.2.2019; nr. 191, datë 5.4.2019; nr. 421, datë 26.6.2019; nr. 1149, datë 24.12.2020; nr. 465, datë 6.7.2022; nr. 241, datë 20.4.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet trajtimi me pagë për mësuesit/ edukatorët punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe punonjësit e tjerë jomësimit që shërbejnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor në:

- a) arsimin parashkollor;
- b) arsimin fillor;
- c) arsimin e mesëm të ulët;
- ç) arsimin e mesëm të lartë;
- d) institucionet arsimore për përkujdesjen për kategori të veçanta të nxënësve.

2. *Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtues në institucionet arsimore të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

2.1. *Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimit në institucionet arsimore, sipas përcaktimit në pikën 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

2/2. *Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtues të institucioneve të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe të konvikteve të nxënësve është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

3. Struktura e pagës mujore përbëhet nga:

3.a) paga e grupit (kolona 2 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), që është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 4, “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfutuar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmbe dhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfutojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës.

Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 4 të vendimit.

3.b) shtesa për vjetërsi pune (*kolona 3 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3*), që aplikohet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën e grupit. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

3.c) shtesa për kualifikim (*kolona 4 e lidhjeve nr. 1 e nr. 3*), që jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si më poshtë vijon:

a) 5% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues i kualifikuar”; b) 10% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues specialist”;

c) 20% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues mjeshtrë”.

Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjes nr. 2), është 0.

3.ç) shtesa e pozicionit, (*kolona 5 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3*) që është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.

4. Përveç pagës, si më sipër, punonjësit mësimorë, që punojnë larg vendbanimit, përfitojnë një kompensim në masën, si më poshtë vijon:

4.a) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 2 700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj.

4.b) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

Në të dyja rastet, kompensimi për largësi nga vendbanimi nuk aplikohet për periudhën gjatë së cilës punonjësi mësimor kryen pushimet vjetore të pagueshme.

5. Punonjësit mësimorë efektivë, të cilët për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore, paguhen për çdo orë mësimore shtesë, si më poshtë vijon:

- Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë 390 lekë/për orë;

- Në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët 300 lekë/për orë.

6. Punonjësit e jashtëm, të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, në shkollat teknike e profesionale si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimorë), për çdo orë mësimore paguhen në të njëjtën masë me punonjësit mësimorë efektivë, si më sipër. 7. Vendimi nr. 194, datë 22.4.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave, të përcaktuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar

(shtuar emërtime me VKM nr. 265, datë 16.5.2018; ndryshuar me VKM nr. 191, datë 5.4.2019; ndryshuar fjalë në rreshtat me numrat rendorë 13 dhe 14, ndryshuar rreshti me numrin rendor 15 me VKM nr. 421, datë 26.6.2019; ndryshuar me vendimin nr. 1149, datë 24.12.2020; ndryshuar me vendimin nr. 465, datë 6.7.2022; ndryshuar me nr. 241, datë 20.4.2023)

| | EMËRTIMI / POZICIONI | Paga individuale | | | PAGA MUJORE |
|----|--|--------------------|---------------------------|-------------------------------------|---------------------|
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit |
| | | | | | 2 |
| 1 | Drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me mbi 700 nxënës. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Drejtor në institucionet e arsimit special. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG. | 80 000 |
| 2 | Drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me 301 deri në 700 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 78 000 |
| 3 | Drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me deri në 300 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 76 500 |
| 4 | Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me mbi 700 nxënës. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Zëvendës drejtor në institucionet e arsimit special. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 71 000 |
| 5 | Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me 301 deri në 700 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 69 800 |
| 6 | Zëvendës drejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me deri në 300 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 68 800 |
| 7 | Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 66 500 |
| 8 | Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 64 600 |
| 9 | Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 63 400 |
| 10 | Drejtor i shkollës fillore klasa I-V. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendës drejtor i shkollës 9-vjeçare. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 62 700 |
| 11 | Mësues në shkollat e arsimit të mesëm të lartë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 58 800 |

| | | | | | |
|----|---|---|---------|------------------------------------|--------|
| | Mësues në institucionet e arsimit special. Mësues i praktikës profesionale. | | | | |
| 12 | Mësues në arsimin e mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 54 800 |
| 13 | Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 51 400 |
| 14 | Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare. | 2 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 48 000 |
| 15 | Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare. Instruktur i praktikës profesionale. | 3 | | | 44 400 |

Lidhja nr. 2

Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimorë në institucionet e arsimit parauniversitar

(shtuar me VKM nr. 60, datë 13.2.2019; ndryshuar numërtimi me VKM nr. 191, datë 5.4.2019; ndryshuar me vendimin nr. 465, datë 6.7.2022; ndryshuar me nr. 241, datë 20.4.2023)

| | EMËRTIMI / POZICIONI | Paga individuale | | | PAGA MUJORE |
|---|---|--------------------|---------------------------|-----------------------------|---------------------|
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa e pozicionit |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | Punonjësit e shërbimit psiko-social. | 1 | 2% e PG | 0 | 48 000 |
| 2 | Oficer i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar. | 1 | 2% e PG | 0 | 48 000 |

Lidhja nr. 3

Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve

(ndryshuar me VKM nr. 191, datë 5.4.2019; ndryshuar me vendimin nr. 1149, datë 24.12.2020; ndryshuar me vendimin nr. 465, datë 6.7.2022; ndryshuar me nr. 241, datë 20.4.2023)

| | EMËRTIMI / POZICIONI | Paga individuale | | | PAGA MUJORE |
|---|--|--------------------|---------------------------|-------------------------------------|---------------------|
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikimin (SHK) | Shtesa e pozicionit |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | Drejtor i konvikteve. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG. | 80 000 |
| 2 | Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 66 500 |
| 3 | Drejtor i kopshtit me ushqim. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; | 58 800 |

| | | | | | |
|----|--|---|---------|------------------------------------|--------|
| | | | | 10% e PG; 20% e PG | |
| 4 | Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 57 500 |
| 5 | Drejtor i kopshtit pa ushqim. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 55 500 |
| 6 | Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 55 500 |
| 7 | Edukator konvikti. Kujdestar konvikti. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 51 400 |
| 8 | Edukator në kopsht fëmijësh. | 1 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 48 000 |
| 9 | Edukator konvikti. Kujdestar konvikti. | 2 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 48 000 |
| 10 | Edukator në kopsht fëmijësh. | 2 | 2% e PG | 5 % e PG; 10% e PG; 20% e PG | 44 400 |

PAGA PËR NIVELIN ARSIMOR
(ndryshuar numërtimi me VKM nr. 191, datë 5.4.2019)

| Grupi | | Niveli i diplomës | Shuma lekë në muaj |
|---------|--|---|--------------------|
| Grupi 1 | Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara | Diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare apo të barasvlershme me to sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin. | 14,000 |
| Grupi 2 | Mësuesi i arsimit parashkollor | Diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor” apo të barasvlershme me to sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin. | 11,000 |
| Grupi 3 | Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit <i>Personeli instruktor i praktikës profesionale, i punësuar me kontratë të përbërshme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme të profilizuar.</i> | Diplomë e shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli “Mësues i shkollës fillore”; Diplomë e shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi; Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e përgjegjëse për Arsimin, si dhe diplomat jouniversitare profesionale dyvjeçare. <i>Diplomë e shkollës së mesme profesionale.</i> | 10,000 |